



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT OF KOSOVO
ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMJIËRA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
INSTITUTI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË
INSTITUTE OF CRIMES COMMITTED DURING THE WAR IN KOSOVO
INSTITUTU ZA ZLOČINE POČINJENE TOKOM RATA U KOSOVU



INSTITUTI I KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË

METODOLOGJIA E DOKUMENTIMIT DHE HULUMTIMIT

Prishtinë

Dhjetor, 2024



TABELA E PËRMBAJTJES

1	HYRJE	4
1.1	Mandati dhe kompetenca ligjore	4
1.2	Politikat operative	4
2	DEPARTAMENTI I DOKUMENTIMIT	5
2.1	MBLEDHJA	5
2.1.1	Identifikimi.....	5
2.1.2	Kontaktimi	7
2.1.3	Marrëveshja.....	7
2.1.4	Dorëzim-pranimi i materialeve.....	8
2.1.5	Metoda alternative për sigurimin e materialeve – blerja/huazimi	8
2.1.6	Strategjia e ndërgjegjësimit për grumbullimin e materialeve.....	9
2.2	VERIFIKIMI	9
2.2.1	Kontrollimi dhe verifikimi i origjinës	10
2.2.2	Verifikimi i autenticitetit.....	11
2.2.3	Krahasimi dhe verifikimi i saktësisë.....	12
2.2.4	Raportimi i rezultateve të verifikuara	13
2.3	PËRPUNIMI DHE ARKIVIMI	13
2.3.1	Përpunimi	13
2.3.2	Përshkrimi.....	16
2.3.3	Arkivimi fizik dhe arkivimi digjital.....	17
2.3.4	Qasja në të dhëna.....	18
3	SIGURIA E ARKIVIT	19
3.1	Mbrojtja e depos së arkivit nga faktorët fizikë.....	19
3.2	Mbrojtja e depos së arkivit nga faktorët kimikë	20
3.3	Mbrojtja e depos së arkivit nga faktorët biologjikë	20
3.4	Plani për sigurinë e materialit arkivor në depo në rast të fatkeqësive	20
4	DEPARTAMENTI I HULUMTIMIT	21
4.1	Menaxhimi dhe përdorimi i materialeve të arkivuara për hulumtim	21
4.2	Hulumtimet akademike.....	22
4.3	Digjitalizimi i materialeve hulumtuese.....	22
4.4	Analizat e specializuara	23
5	KONKLUZION	23



TABELA E FIGURAVE

Figura 1. Konteksti kohor dhe gjeografik i fushëveprimtarisë së IKKL-së	4
Figura 2. Hapat metodologjikë të përfshirë në punën e Departamentit të Dokumentimit.....	5
Figura 3. Përmbledhje e burimeve parësore dhe dytësore të materialeve arkivore që janë me interes për Departamentin e Dokumentimit.....	6
Figura 4. Hapat e përfshirë në procesin e verifikimit	10
Figura 5. Organizimi i materialeve në sistemin fizik të arkivës së IKKL-së	14
Figura 6. Klasifikimi i krimeve të luftës për qëllime të dokumentimit dhe hulumtimit	14
Figura 7. Kategorizimi i dëmeve për qëllime të dokumentimit dhe hulumtimit.....	15
Figura 8. Procesi i digjitalizimit.....	17
Figura 9. Faktorët kryesorë në ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumenteve që përfshijnë ato fizikë, kimikë dhe biologjikë	19
Figura 10. Hapat e përfshirë në procesin e punës së Departamentit të Hulumtimit.....	21



1 HYRJE

1.1 Mandati dhe kompetenca ligjore

Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL) është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 08/L-177 për IKKL-në. Ky ligj përcakton gjithashtu organizimin dhe funksionimin e brendshëm të IKKL-së, duke përcaktuar atë si një agjenci brenda Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Sipas këtij ligji, IKKL-ja është përgjegjës për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, duke siguruar mbledhjen e të dhënave për humbjet njerëzore, dëmet fizike dhe psikologjike, humbjet ekonomike/materiale, dëmet mjedisore, dëmtimin e pronës kulturore dhe llojeve të tjera dëmsh të shkaktuara nga krimet e luftës. Kjo përfshin krimet e kryera mes datës 1 janar 1998 dhe 20 qershor 1999, si dhe krime të tjera të lidhura me luftën deri më 31 dhjetor 2000, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj. IKKL-ja gjithashtu ka mandat për të dokumentuar dhe hulumtuar krimet dhe veprimet e tjera që kanë çuar te lufta në Kosovë; qëllimi është të dokumentohen dhe të paraqiten të gjitha faktet historike që lidhen drejtpërdrejt me luftën. Territori i Kosovës është i definuar si kufijtë gjeografikë të Republikës së Kosovës (figura 1). Mandati i IKKL-së përqendrohet në mbledhjen, verifikimin, përpunimin, arkivimin, hulumtimin dhe publikimin e të dhënave mbi krimet e kryera gjatë luftës, si dhe në sigurimin e qasjes publike për viktimat dhe palët e interesuara.

Për të siguruar standardet më të larta të pranueshmërisë, qasja e IKKL-së buron nga Kodi i Procedurës Penale i Kosovës dhe standardet ndërkombëtare ligjore, duke përfshirë praktikën e përdorur nga gjykatat ndërkombëtare dhe hibride.



Figura 1. Konteksti kohor dhe gjeografik i fushëveprimtarisë së IKKL-së

1.2 Politikat operative

Politikat operative të IKKL-së janë thelbësore në ndërtimin e një ambienti profesional, të pavarur dhe transparent, në të cilin do të kryhen aktivitetet e tij. Këto politika përfshijnë ligjshmërinë, pavarësinë, paanshmërinë, transparencën, mosdiskriminimin, konfidencialitetin, një etikë të fokusuar te viktimat, barazinë gjinore dhe mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijëve. Bazuar në këto politika, IKKL-ja do të sigurojë që të gjitha aktivitetet e tij të ndjekin standardet më të larta etike dhe profesionale, dhe të garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut të të gjitha palëve të përfshira në procesin e dokumentimit dhe hulumtimit të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.

I tërë procesi i punës së dokumentimit dhe hulumtimit në IKKL është i strukturuar dhe i organizuar përmes dy departamenteve kryesore: **Departamenti i Dokumentimit** dhe **Departamenti i Hulumtimit**. Këto departamente luajnë rol thelbësor në realizimin e misionit të Institutit dhe janë të ndërthurura dhe të koordinuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike në dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të luftës.

2 DEPARTAMENTI I DOKUMENTIMIT

Departamenti i Dokumentimit është njësi organizative brenda IKKL-së, i cili ka për mision i) mbledhjen, ii) verifikimin dhe iii) përpunimin dhe arkivimin e të dhënave (figura 2), me qëllim të dokumentimit të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Ky kapitull përshkruan metodologjinë specifike të përdorur për të arritur këto qëllime, e cila është dizajnuar për të siguruar një proces të strukturuar dhe të qëndrueshëm në dokumentimin e krimeve duke garantuar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të mbledhura.




Figura 2. Hapat metodologjikë të përfshirë në punën e Departamentit të Dokumentimit

2.1 MBLEDHJA

Strategjia për mbledhjen e të dhënave në IKKL përfshin një proces të strukturuar që përbën disa hapa kyçe. Fillimisht, identifikohen burimet e mundshme, si individë, institucione dhe organizata, që mund të kenë materiale të rëndësishme. Pas identifikimit, këto palë kontaktohen dhe informohen për punën e Institutit, dhe kërkohet bashkëpunimi i tyre. Ky proces vazhdon me një marrëveshje për transferimin e materialeve ose provave përkatëse, të cilat pastaj dokumentohen me kujdes.

Përveç këtyre hapave, strategjia parashikon gjithashtu opsione alternative, si blerja ose huazimi i materialeve kur është e nevojshme. Për të zgjeruar më tej mbledhjen e provave, IKKL-ja do të zhvillojë strategji angazhimi publik për mbledhjen e materialeve përmes aktiviteteve sensibilizuese në medie tradicionale dhe sociale, dhe duke ftuar individët dhe organizatat që disponojnë materiale relevante t'i ndajnë ato me IKKL-në. Edhe në rastet kur materialet blihen ose huazohen, ose kur individët, institucionet dhe organizatat ofrojnë materiale, ndiqen të njëjtit hapa të strukturuar, për të siguruar që të gjitha materialet të dokumentohen në një mënyrë të organizuar dhe të kontrolluar.

2.1.1 Identifikimi

Procesi i identifikimit fillon me përcaktimin e krimit për të cilin IKKL-ja ka mandatin për të mbledhur prova (shih kapitullin 1.1) dhe specifikimin e burimeve të nevojshme për mbledhjen e provave për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të luftës. Brenda këtij procesi, fokusi kryesor do të jetë në identifikimin e burimeve primare dhe sekondare të materialeve arkivore që i interesojnë Departamentit të Dokumentimit (figura 3).



Figura 3. Përmbledhje e burimeve parësore dhe dytësore të materialeve arkivore që janë me interes për Departamentin e Dokumentimit

Burimet e identifikuara përfshijnë:

- **Dokumente zyrtare të qasshme:** të dhëna ushtarake, transkripte gjyqësore, raporte qeveritare dhe çdo dokument tjetër që lidhet me ngjarjet e luftës. Këto përfshijnë plane operacionale, urdhra dhe raporte të betejave, raporte gjyqësore me dëshmi të detajuara dhe vendime, si dhe dokumente qeveritare që lidhen me hetimet e brendshme dhe vendimet institucionale;
- **Të dhëna zyrtare për viktimat:** certifikata e vdekjes, raporte për personat e zhdukur, baza e të dhënave të refugjatëve dhe raporte nga ekzaminimet e varrezave masive;
- **Dokumentacioni ligjor:** çdo dokumentacion në lidhje me rastet e dhunës seksuale, përfshirë dosjet gjyqësore, raportet nga procedurat ligjore, si dhe evidencat forenzike si: mostrat e ADN-së dhe shenjat e lëndimeve;
- **Raporte mjeko-ligjore:** analiza të skenave të krimit, armë të përdorura dhe mbetje njerëzore nga ekspertët e mjekësisë ligjore;
- **Dëshmi fizike:** fotografi, video dhe materiale të tjera që ndërlidhen me krimet e luftës;
- **Dëshmi të respondentëve:** intervista të disponueshme me të mbijetuar, viktimë dhe dëshmitarë të ngjarjeve të krimeve të luftës;
- **Dëshmi të autorëve të krimeve:** deklarata ose dëshmi të disponueshme nga individë të përfshirë në krimet e luftës ose nga ata me njohuri për ngjarjet;
- **Individë privatë:** individë që kanë koleksionuar dosje të ndryshme me vlerë arkivore;
- **Raporte nga organizatat joqeveritare dhe grupet e të drejtave të njeriut:** organizata që kanë dokumentuar krimet e luftës dhe kanë krijuar arkiva ose biblioteka me dokumente të rëndësishme për hulumtimin e ngjarjeve të luftës;



- **Institucione zyrtare me mandat të përafërt me IKKL-në:** institucione që kanë mbledhur dhe ruajtur të dhëna të rëndësishme për luftën;
- **Raporte nga institucionet ndërkombëtare:** qeveri, institute, organizata ndërkombëtare të sigurisë dhe subjekte të tjera juridike, ushtarake e civile, të cilat kanë mbledhur materiale dhe kanë hartuar raporte që ofrojnë perspektiva të ndryshme mbi krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë;
- **Raporte mediatike:** artikuj gazetash, dokumentarë dhe përmbajtje mediatike nga mediet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare, të ruajtura në arkiva fizike dhe digjitale, duke përfshirë lajme, kronika, intervista dhe pamje të realizuara gjatë luftës;
- **Botime dhe literaturë:** libra dhe botime që dokumentojnë ngjarjet e luftës dhe krimet e kryera në Kosovë;
- **Publikime akademike:** vepra shkencore vendore dhe ndërkombëtare/artikuj shkencorë të recenzuar që ofrojnë analiza të thella të kontekstit historik të luftës në Kosovë;
- **Të dhëna ekonomike:** anketa, raporte dhe studime që synojnë matjen e dëmit ekonomik, vlerësojnë ndikimin financiar tek individët dhe komunitetet, duke përfshirë regjistrat e biznesit, dokumentet tatimore dhe pasqyrat financiare;
- **Të dhëna mjedisore:** raporte, studime, anketime, fotografi dhe video që dokumentojnë dëmet në ambient;
- **Të dhëna mbi pronën kulturore:** fotografi dhe video që dokumentojnë dëmtimet strukturore dhe ndryshimet fizike të objekteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore si: kisha, xhami, ndërtesa historike, hapësira arkeologjike apo objekte të ngjashme.

2.1.2 Kontaktimi

Pasi janë identifikuar burimet, hapi i radhës është krijimi i kontakteve dhe mbledhja e dokumentacionit dhe materialeve që dokumentojnë krimet e kryera gjatë luftës. Kjo përbën fazën e dytë të procesit dhe është thelbësore për të siguruar një mbledhje të suksesshme të të dhënave të besueshme dhe të verifikuara nga burime të ndryshme. Krijimi i këtyre kontakteve kërkon një qasje të kujdesshme dhe të ndjeshme, duke respektuar ndjeshmërinë dhe përvojat e të mbijetuarve dhe dëshmitarëve, duke garantuar njëkohësisht konfidencialitetin dhe sigurinë e tyre. Bashkëpunimi i suksesshëm me burimet është thelbësor për të siguruar që të gjitha materialet e mbledhura të jenë të sakta, të plota dhe të dobishme për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të luftës.

2.1.3 Marrëveshja

Pas kontaktit të suksesshëm me palën, hapi i ardhshëm është arritja e një marrëveshjeje për dorëzim-pranim të materialeve. Marrëveshja përfshin:

- **Dispozitat e përgjithshme dhe kushtet specifike:** termat dhe kushtet për dorëzim-pranim përcaktohen qartë në marrëveshje. Këto përfshijnë llojin dhe sasinë e materialeve që do të dorëzohen dhe çdo kusht specifik që pala dorëzuese mund të vendosë, si kufizime në përdorim, ruajtje ose shpërndarje të materialeve;
- **Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale:** marrëveshja duhet të adresojë qartë çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale mbi materialet e dorëzuara. Kjo përfshin sqarimin e pronësisë së materialeve pas dorëzimit, të drejtën e IKKL-së, për t'i përdorur ato për qëllime dokumentuese dhe hulumtuese, dhe çdo kufizim në lidhje me riprodhimin ose publikimin e materialeve;
- **Zbatueshmëria ligjore:** marrëveshja duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse, duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtave të pronësisë intelektuale. IKKL-ja duhet të sigurohet që marrëveshja të jetë juridikisht e vlefshme dhe e zbatueshme, dhe që të gjitha palët të jenë të informuara dhe të pajtuara me të gjitha termat dhe kushtet e përcaktuara.



Faza e negociatave dhe formalizimit të marrëveshjes është thelbësore për të siguruar që procesi i dorëzim-pranimit të materialeve të jetë transparent, i drejtë dhe në përputhje me standardet ligjore dhe etike të IKKL-së. Gjithashtu, garanton që të gjitha palët të jenë të mbrojtura dhe që materialet e mbledhura të përdoren në mënyrë të përgjegjshme dhe efektive.

2.1.4 Dorëzim-pranimi i materialeve

Pas arritjes së marrëveshjes, kryhet procesi i dorëzim-pranimit të materialeve. Ky proces përfshin:

- **Emërimi i komisionit të pranimit:** IKKL-ja emëron një komision të veçantë për pranimin e materialit, i cili shqyrton dhe verifikon kushtet e përgjithshme dhe specifike lidhur me dorëzimin e materialit. Komisioni është përgjegjës për vlerësimin e llojit, sasisë, periudhës kohore, gjendjes dhe të dhënave të tjera të materialit të dorëzuar;
- **Përpilimi i procesverbalit dhe regjistrimit për dorëzimin e materialit arkivor:** procesi i dorëzim-pranimit realizohet në formë standarde përmes *procesverbalit për dorëzimin e materialit arkivor*, një dokument që përfshin të gjitha informacionet themelore në lidhje me palën dhe materialet e dorëzuara. Nëse pala kërkon kufizime në përdorimin e materialeve, kjo shënohet në këtë dokument. Një pjesë integrale dhe e detyrueshme e *procesverbalit* është *regjistri i materialeve arkivore të dorëzuara*. Regjistri plotësohet nga personi që dorëzon materialin dhe, së bashku me komisionin e dorëzimit, identifikohen dhe regjistrohen natyra dhe sasia e materialeve të dorëzuara. *Procesverbali* dhe *Regjistri* dokumentohen në dy kopje origjinale, një për palën që dorëzon dhe një për IKKL-në;
- **Nënshkrimi dhe miratimi:** pas kompletimit të këtyre dokumenteve, të dyja palët nënshkruajnë dokumentet për të finalizuar dorëzim-pranimin. Këto nënshkrime vërtetojnë që të gjitha kushtet dhe detyrimet janë të qarta dhe të pranuar nga të dyja palët. Pas nënshkrimit, të gjitha të drejtat dhe detyrimet kalojnë te IKKL-ja, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe;
- **Evidentimi i materialit:** pas pranim-dorëzimit, materiali regjistrohet në *Librin e Inventarit Hyrës* brenda IKKL-së, një mjet themelor për garantimin dhe ruajtjen e dokumenteve. Ky libër shërben si dokument zyrtar që dëshmon pronësinë e materialit dhe është referenca e parë për informacionin e materialit të pranuar. Ai është udhërrëfyes deri te dokumenti dhe jo udhërrëfyes nëpër dokumente. *Libri i Inventarit Hyrës* do të digjitalizohet për nevoja të brendshme të IKKL-së.

2.1.5 Metoda alternative për sigurimin e materialeve – blerja/huazimi

Në raste të veçanta, kur materiali i nevojshëm për dokumentim dhe hulumtim nuk është i disponueshëm përmes rrugëve standarde të dorëzim-pranimit, IKKL mund të përdorë një hap alternativ: blerjen ose huazimin e materialeve nga palë të treta. Ky hap është i nevojshëm kur materiali është i rrallë, unik ose me vlerë të madhe për misionin dhe qëllimet e veprimtarisë së IKKL-së.

Përpara se të realizohet blerja, duhet të kryhet një analizë e thelluar për të vlerësuar rëndësinë dhe vlerën e veçantë të materialit në fjalë. Kjo përfshin shqyrtimin e vlefshmërisë së materialit për dokumentimin dhe hulumtimet që realizon IKKL-ja, si dhe veçantinë e tij. Arsyetimi për blerjen duhet të jetë i qartë dhe i dokumentuar, duke u bazuar në vlerën që ky material do të shtojë në arkivat e IKKL-së dhe në përmbajtjen e tij, për të ndihmuar në zbardhjen e krimeve të kryera gjatë luftës. Pas miratimit për blerje, hapat e mëtejshëm përfshijnë negociatat me pronarin e materialit për të arritur një çmim të pranueshëm. Pas arritjes së marrëveshjes, nënshkruhet një kontratë që detajon të gjitha obligimet dhe kushtet e blerjes, përfshirë të drejtat e pronësisë që duhet të kalojnë te IKKL-ja, si dhe çdo e drejtë dhe kufizim që mund të definohet në kontratë.

Huazimi mund të jetë një alternativë e vlefshme kur blerja e materialit nuk është e mundur ose e nevojshme, por kur ende materiali është i rëndësishëm për hulumtim në kuadër të IKKL-së. Kjo mund



të ndodhë kur materiali është i lidhur me një subjekt që dëshiron të ruajë të drejtat e pronësisë, por është i gatshëm të ofrojë qasje në materialin përkatës për një periudhë të caktuar. Arsyetimi për huazim duhet të përfshijë arsyetimin e nevojës për qasje në material dhe për vlerën e tij të shtuar. Negociatat për huazimin e materialit duhet të përfshijnë një marrëveshje të detajuar që përcakton kushtet dhe rregullat e huazimit, përfshirë kohëzgjatjen e huazimit, kushtet e ruajtjes së materialit gjatë transportit dhe periudhës së huazimit, si dhe çfarëdo kufizimi në përdorim që mund të vendosë pronari. Marrëveshja duhet të përfshijë, gjithashtu, detaje për kthimin e materialit në gjendjen e tij origjinale, dhe çdo masë që duhet të merret për mbrojtjen e materialit gjatë huazimit. Nëse materiali i huazuar është digjital, mund të përfshihet edhe kufizimi në qasje ose përdorim të mëvonshëm, bazuar në kushtet e marrëveshjes.

Gjithë procesi i blerjes ose huazimit të materialeve duhet të procedohet në mënyrë ligjore dhe transparente. Kjo përfshin dokumentimin e të gjitha negociatave, vlerësimeve, marrëveshjeve dhe pagesave eventuale. Këto dokumente duhet të jenë të qasshme për auditime të brendshme ose të jashtme, për të siguruar që proceset janë kryer bazuar në nevojat objektive, në mënyrë të drejtë, proporcionale dhe të ligjshme.

2.1.6 Strategjia e ndërgjegjësimit për grumbullimin e materialeve

Një metodë tjetër që mund të aplikohet në mbledhjen e të dhënave është krijimi i një strategjie për të nxitur vetë individët t'i dorëzojnë dokumentet dhe materialet të cilat mund t'i posedojnë, pa pasur nevojë që zyrtarët e Institutit të shkojnë tek ata. Kjo strategji përfshin përdorimin e platformave të ndryshme digjitale, si Facebook, Instagram, X dhe të tjera, për të arritur një audiencë sa më të gjerë.

Gjithashtu, përdorimi i faqes zyrtare të IKKL-së në këto platforma dhe pasurimi i saj mund të ndihmojë në shpërndarjen e mesazhit dhe në inkurajimin e njerëzve që të ndajnë materialet e tyre. Po ashtu, krijimi i një platforme online, ku përdoruesit mund të ngarkojnë dokumente dhe dëshmi në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale mund të jetë një hap i rëndësishëm në këtë proces. Megjithatë, është e domosdoshme që kjo mundësi të ofrohet duke vendosur masa të rrepta sigurie për të parandaluar çdo tentativë për keqpërdorim. Për shembull, mund të implementohen filtra dhe mekanizma verifikimi për të shmangur ngarkimin e materialeve jo të vlefshme apo të qëllimshme, duke siguruar që platforma të ruajë integritetin dhe cilësinë e të dhënave të dorëzuara.

Për ata që nuk përdorin rrjete sociale ose platforma digjitale, duhet të ofrohen alternativa të tjera. Kjo mund të përfshijë organizimin e takimeve të komuniteteve, shpërndarjen e fletushkave dhe njoftimeve, si dhe krijimin e linjave telefonike të dedikuara ku njerëzit mund të kontaktojnë dhe të dorëzojnë materialet e tyre.

Po ashtu, organizimi i fushatave për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e dokumentimit të krimeve të luftës është thelbësor, i cili përfshin bashkëpunimin me medie, organizata joqeveritare dhe institucione të tjera për të shpërndarë informacione dhe për të nxitur pjesëmarrjen e publikut në procesin e mbledhjes së dokumenteve.

2.2 VERIFIKIMI

Verifikimi i të dhënave është një proces shumëdimensional dhe kompleks që përfshin disa faza kyçe për të siguruar saktësinë, besueshmërinë dhe autenticitetin e materialeve të mbledhura. Fillimisht, ky proces përfshin identifikimin dhe kategorizimin e burimeve të ndryshme të informacionit për të verifikuar autenticitetin dhe besueshmërinë e tyre. Pasi origjina është konfirmuar, faza tjetër është verifikimi i autenticitetit të materialeve, ku dokumentet dhe provat kalojnë një proces rigoroz për të siguruar vlefshmërinë e tyre. Më pas, të dhënat krahasohen dhe verifikohen për të siguruar saktësinë dhe konsistencën duke përdorur metoda të tilla si, intervista të tjera dhe triangulimi i burimeve.

Një aspekt i rëndësishëm i verifikimit është edhe vlerësimi profesional nga ekspertë të fushave përkatëse, të cilët ofrojnë analiza të thelluara për të garantuar autenticitetin dhe cilësinë e të dhënave. Po ashtu, duhet të theksohet se verifikimi bëhet sipas rastit në rast, duke ndjekur disa prej parimeve të përgjithshme, të aplikueshme në të gjitha rastet.

Përfundimisht, rezultatet e verifikimit dokumentohen në raporte të detajuara, të cilat përfshijnë përshkrime të metodave të përdorura dhe gjetjet kryesore, duke siguruar që informacioni të jetë i përdorshëm dhe i besueshëm për hulumtime të mëtejshme. Të gjitha fazat e verifikimit (figura 4) do të përshkruhen në nënkapitujt e mëposhtëm.



Figura 4. Hapat e përfshirë në procesin e verifikimit

2.2.1 Kontrollimi dhe verifikimi i origjinës

Kontrollimi dhe verifikimi i origjinës është hap themelor në procesin e verifikimit, i cili synon të sigurojë që burimet e informacionit janë autentike, të besueshme dhe të përshtatshme për t'u përdorur në dokumentim dhe hulumtim.

Fillimisht, te procesi i kontrollimit dhe verifikimit të origjinës të materialeve është thelbësore të bëhet identifikimi dhe kategorizimi i burimit të të dhënave. Ky proces fillon me plotësimin e *Formës së Përmbajtjes* të IKKL-së, e cila i përshkruhet secilës dosje dhe, e cila i përmban të dhënat kryesore të dosjes. Plotësimi i *Formës së Përmbajtjes* përcakton gjendjen e dosjes si dhe konfirmon kontrollimin dhe verifikimin e origjinës së burimit. Struktura e saj është e ndërtuar nga disa kategori të cilat definojnë qartë identifikimin e burimit; natyrën e përmbajtjes; llojin dhe parametrat fizikë të materialit; specifikat e dosjes.

- **Shifra:** përfshin numrin rendor të dosjes, origjinën e burimit dhe inventarizimin e të dhënave;
- **Pika e përmbajtjes:** përfshin të dhëna faktike rreth materialit dhe varësisht nga natyra e rastit mund të jetë listë e shkurtër apo e gjatë. Dosja mund të ketë përmbajtje të strukturuar, e cila përfshin të dhëna si: dëshmi, dëshmi fizike - fotografi apo video, dokumente ligjore dhe mjekësore, institucionale, ose dosja mund të ketë përmbajtje të pastrukturuar;
- **Parametrat fizikë:** përfshin llojin e materialit - fizik apo elektronik, numrin e faqeve dhe formatin e materialit;
- **Vërejtje:** përfshin evidentimin dhe përshkrimin e mangësive potenciale, të dhënave shtesë dhe specifikat përkatëse të dosjes, nëse ka.



Duhet të kihet parasysh se strukturimi i *Formës së Përmbajtjes* mund të ndryshoj varësisht nga diversiteti i përmbajtjes së të dhënave të dosjes dhe nga praktikat e IKKL-së.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në verifikimin e origjinës së burimit është kontekstualizimi i burimit. Kjo përfshin vlerësimin e rrethanave në të cilat është krijuar dhe përdorur burimi. Për shembull, nëse burimi është një dokument i shkruar me dorë, është e rëndësishme të merret parasysh konteksti historik dhe gjeografik në të cilin është krijuar ai dokument, për të vlerësuar nëse është i besueshëm dhe për t'u siguruar që nuk është një falsifikim ose një dokument që ka humbur vlerën për shkak të ndryshimeve në rrethanat e krijimit të tij.

Për burimet dytësore, siç janë raportet e organizatave joqeveritare apo atyre mediatike, është thelbësore të shqyrtohet reputacioni i burimit dhe historia e tij kur të raportohen ngjarje të ngjashme. Një organizatë me reputacion të mirë dhe me një histori të gjatë në dokumentimin e krimeve të luftës mund të konsiderohet një burim më i besueshëm krahasuar se sa një burim më pak të njohur ose me një histori të dyshimtë.

Kjo strukturë siguron që çdo dokument të ketë një origjinë të saktë dhe të besueshme, duke lejuar një proces të qëndrueshëm të verifikimit.

2.2.2 Verifikimi i autenticitetit

Verifikimi i autenticitetit të të dhënave është hap kyç dhe bëhet krahas hapave dhe metodave të tjera në procesin e vlerësimit të verifikimit. Pas njohjes dhe identifikimit të burimeve parësore, siç janë dëshmitë e dëshmitarëve, dokumentet zyrtare, fotot, audiot apo video materialet - duhet të verifikohet legjitimiteti dhe kredibiliteti i personit apo institucionit që e ka prodhuar atë dëshmi, dokument apo material është thelbësor. Për shembull, në rastin e dokumenteve mjekësore, është e rëndësishme të verifikohet nëse dokumenti është lëshuar nga një institucion kredibil mjekësor, pra nëse ka nënshkrimin e mjekut të autorizuar dhe nëse përmban vulën e institucionit, që rrjedhimisht na siguron që dokumenti në fjalë është autentik ose jo, sa i përket aspektit administrativ të dokumentit, dhe pastaj, vetëm pas vlerësimeve profesionale konfirmohet autenticiteti i përmbajtjes së tij.

Gjithashtu, si pjesë e procedurës penale, është thelbësore të sigurohet që të dhënat të jenë ligjërish të vlefshme dhe të përdorshme. Kjo përfshin një segment që verifikon pranueshmërinë e provave në kontekste ligjore, duke vlerësuar nëse të dhënat përmbushin standardet e nevojshme ligjore për t'u përdorur në procese akuzash ose raste gjyqësore.

Po ashtu, për dokumentet zyrtare është thelbësore të verifikohet nëse dokumenti është i protokolluar zyrtarisht dhe nëse përmban të gjitha elementet e nevojshme siç janë vula dhe nënshkrimi, për të konfirmuar autenticitetin e origjinës së tij. Autenticiteti i plotë i të dhënave mund të konfirmohet vetëm pas vlerësimit profesional, varësisht prej specifikave të rastit/ngjarjes, e duke u bazuar sipas nevojës edhe në:

- analiza balistike;
- analiza forenzike;
- analiza kohore;
- analiza digjitale;
- krahasime të të dhënave me burime të tjera kredibile zyrtare;
- vlerësimin e konsistencës krahas të dhënave të tjera.

Ndjekja e këtyre hapave në procesin e verifikimit të autenticitetit si dhe sigurimi i rezultateve cilësore të vlerësimit profesional na sigurojnë që dokumentet janë të besueshme dhe të gatshme të shpërfaqen para opinionit publik.



2.2.3 Krahassimi dhe verifikimi i saktësisë

Verifikimi i saktësisë së të dhënave është një proces i shumëfishtë që përfshin një sërë metodash për të konfirmuar dhe korrigjuar informacionin para përdorimit të tij në raportet përfundimtare. Ky proces është thelbësor për të garantuar të dyja: integritetin e materialeve të mbledhura dhe për të siguruar që ato përfaqësojnë në mënyrë të drejtë dhe të saktë ngjarjet dhe faktet e dokumentuara.

- **Krahassimi i informatave:** është metodë thelbësore në procesin e verifikimit të saktësisë. Kjo përfshin krahassimin e të dhënave të mbledhura me burime të tjera, për të identifikuar dhe korrigjuar çdo mospërputhje. Burimet e krahassimit mund të përfshijnë dokumente zyrtare, raporte të organizatave joqeveritare, raporte mediatike, publikime akademike dhe të tjera. Triangulimi i të dhënave është një teknikë e veçantë përmes së cilës informacioni verifikohet duke përdorur më shumë se dy burime kredibile dhe të pavarura. Kjo metodë është veçanërisht efektive për të siguruar që të dhënat janë të konsistencës dhe të saktësisë së lartë, duke reduktuar mundësinë e gabimeve ose manipulimeve. Mirëpo, në rastet e proceduara nga gjykatat vendore apo ndërkombëtare, atëherë prova (të dhënat) bëhet automatikisht e besueshme, vetëm se duhet të administrohet dhe të jepet referenca e qartë. Natyrisht, kjo bëhet pas krahassimit të materialit apo dëshmisë së ofruar dhe provës së administruar nga gjykata.
- **Konsistenca e të dhënave:** është metodë thelbësore për të siguruar që informacionet e mbledhura janë të qëndrueshme dhe të besueshme. Kjo përfshin kontrollimin e saktësisë së të dhënave faktike duke përfshirë identifikimin personal të dëshmitarëve, kohën dhe vendin e ngjarjeve, si dhe natyrën e ndodhive të përshkruara. Konsistenca e të dhënave është veçanërisht e rëndësishme kur ekzistojnë më shumë se një dëshmi për të njëjtin rast ose kur të dhënat janë mbledhur nga burime të shumta për një ngjarje specifike. Për shembull, kur dy dëshmitarë japin dëshmi për të njëjtin rast, është thelbësore që të krahassohen dëshmitë e tyre për të siguruar që ato përputhen në aspektet kryesore si koha, vendi dhe rrethanat e ngjarjes. Po ashtu, gjatë metodës krahassimtare duhet pasur parasysh rastet kur dy dëshmitarë flasin për të njëjtin rast/ngjarje, mirëpo specifikojnë kohë të ndryshme. Në këso rastesh, duhet të bëhet intervistim i thellë apo duhet të shihen mundësitë e krahassimit me dokumente zyrtare.
- **Vlerësimi profesional:** nënkupton rastet kur kërkohet ekspertizë specifike, është e domosdoshme angazhimi i profesionistëve të fushave përkatëse për të verifikuar saktësinë dhe autenticitetin e të dhënave. Kjo mund të përfshijë ekspertizë ligjore për të vlerësuar vlefshmërinë e dokumenteve juridike, analiza balistike për të përcaktuar përdorimin e armëve në një ngjarje të caktuar, ose vlerësime forenzike për të analizuar dëshmitë fizike si ADN-ja ose shenjat e lëndimeve. Përveç kësaj, ekspertiza digjitale mund të përdoret për të verifikuar autenticitetin e materialeve të ruajtura në format digjital, si fotografi, audio, video ose dokumente të skanuara. Ekspertizat profesionale ndihmojnë në ofrimin e sigurisë që të dhënat të jenë të verifikuara nga një perspektivë teknike dhe profesionale, duke kontribuar në besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre në procesin e dokumentimit dhe hulumtimit të krimeve të luftës.
- **Intervistimi për rikonfirmim të saktësisë:** kjo metodë aplikohet në rastet kur dëshmitë e mbledhura mund të jenë të paqarta ose të mangëta për shkak të distancës kohore, traumës së përjetuar nga dëshmitarët, ose faktorëve të tjerë që ndikojnë në kujtesën e tyre. Për të adresuar këto çështje, mund të jetë e nevojshme të zhvillohen intervista shtesë me dëshmitarët për të rishqyrtuar dhe rikonfirmuar saktësinë e të dhënave të mbledhura. Gjatë këtyre intervistave, duhet të përdoren teknika të kujdesshme dhe pyetje të strukturuar për të ndihmuar dëshmitarët të kujtojnë detajet e ngjarjeve dhe për të siguruar që informacioni i dhënë është i saktë dhe i plotë.
- **Vlerësimi përfundimtar i të dhënave:** është metoda e fundit e procesit të verifikimit që siguron saktësinë, besueshmërinë dhe vlefshmërinë e informacionit të mbledhur, para se të përdoret në raportet përfundimtare. Gjatë këtij procesi, duhet të theksohen nivelet e vlerësimit, pasi që disa



të dhëna mund të jenë të paverifikueshme, ose vështirë të verifikueshme. Në disa raste, mund të jetë e nevojshme të kryhen vizita në terren për të verifikuar informacionin e mbledhur nga intervistat dhe dokumentet, megjithatë kjo nuk do të jetë një metodë standarde. Këto vizita mund të ndihmojnë në konfirmimin e saktësisë së detajeve gjeografike dhe në vërtetimin e ekzistencës dhe gjendjes aktuale të vendeve të përmendura në të dhënat e mbledhura. Gjatë vizitave në terren, mund të kryhen verifikime vizuale, të bëhen fotografi dhe video për dokumentacion dhe të realizohen matje për t'i krahasuar me informacionet e mbledhura më parë. Gjithsesi, duhet pasur parasysh diferencën kohore nga përfundimi i luftës deri në dokumentimin aktual të krimeve, që mund të ketë ndikuar në ndryshimet e toponimeve të vendbanimeve dhe saktësinë e detajeve të mbledhura.

2.2.4 Raportimi i rezultateve të verifikuara

Pas përfundimit të procesit të verifikimit, duhet të përpilohet një raport përfundimtar që përmban të dhëna të verifikuara për secilën dosje. Ky raport paraqet përshkrim të detajuar të metodave të përdorura gjatë procesit të verifikimit, kategorive të dokumenteve, vlerësimin për saktësinë kohore, gjeografike, rezultatet nga krahasimi me dokumente të tjera zyrtare dhe vlerësimin përfundimtar të saktësisë së informacionit. Raporti përfundimtar përmbyll një proces të dokumentuar në mënyrë transparente dhe të strukturuar, që i riafirmon të dhënat e mbledhura si të besueshme dhe të verifikuara.

Një element tjetër i rëndësishëm në përmbylljen e tërë procesit të verifikimit të të dhënave është krijimi i një komisioni profesional brenda IKKL-së, i cili vlerëson materialet që nuk plotësojnë kriteret e përmendura më sipër dhe për rrjedhojë duhet të eliminohen para se të vazhdohet me përpunimin dhe arkivimin.

2.3 PËRPUNIMI DHE ARKIVIMI

Përpunimi dhe arkivimi i të dhënave përfshin një sërë hapash të ndërlidhur që sigurojnë trajtimin dhe ruajtjen e duhur të materialeve të mbledhura. Fillimisht, të dhënat përpunohen për t'u organizuar dhe strukturuar në mënyrë që të lehtësojnë përdorimin e tyre të mëvonshëm. Më pas, përshkrimi i detajuar i këtyre materialeve krijon regjistra që ndihmojnë në identifikimin dhe klasifikimin e saktë të tyre. Arkivimi i materialeve siguron ruajtjen afatgjatë në kushte të përshtatshme, ndërsa digjitalizimi mundëson konvertimin e tyre në formate digjitale për të siguruar qasje më të lehtë dhe mbrojtje nga dëmtimi fizik. Përfundimisht, qasja në të dhëna i referohet mundësisë që publiku dhe palët e interesuara të kenë qasje në materialet fizike dhe digjitale, duke siguruar kështu një transparencë të plotë dhe një mbështetje për hulumtimin e krimeve të luftës në Kosovë.

2.3.1 Përpunimi

Përpunimi i materialeve të mbledhura është një hap i rëndësishëm në sigurimin e organizimit dhe sistematizimit të të dhënave. Protokolli për përpunimin dhe arkivimin e të dhënave përfshin krijimin e bazave të të dhënave, përcaktimin e kategorive, dhe sistemimin e materialeve duke ndjekur standarde të caktuara. Ky protokoll është thelbësor për të siguruar që proceset të jenë të dokumentuara, të qëndrueshme dhe në përputhje me praktikën më të mira të arkivistikës.

Në këtë fazë, krijimi i një baze të dhënash të mirëstrukturuar është thelbësor për të mbështetur procesin e kategorizimit dhe klasifikimit të materialeve. Kjo bazë e të dhënave duhet të jetë e dizajnuar për të përmbushur nevojat specifike të hulumtimit, duke marrë parasysh aspektet historike, ushtarake, ekonomike, juridike, ekologjike, kulturore, psikologjike, mjeko-ligjore dhe sociologjike. Një bazë e mirëorganizuar e të dhënave e ndihmon ruajtjen e tyre në një format të organizuar dhe lehtësisht të qasshëm.

Për të siguruar që procesi i materialit të jetë sa më efikas, IKKL-ja do të krijojë një komision të brendshëm që do të vendosë formën e kategorizimit dhe klasifikimit të materialeve. Kategorizimi i përgjithshëm përfshin përcaktimin e kategorive të qarta dhe të standardizuara për secilën temë dhe nëntemë kryesore, duke e ndarë materialin në grupe logjike që pasqyrojnë natyrën e krimeve të dokumentuara.

Përpunimi fillon me krijimin e regjistrave për të gjithë materialin e depozituar në IKKL, më pastaj materiali procesohet fond për fond (koleksion pas koleksioni) si dhe lëndë për lëndë duke i vendosur numrat rendor të caktuar për secilën lëndë (figura 5). Numra të cilët gjithashtu shënohen në listat e brendshme të kutive në të cilat vendosen lëndët e përpunuara.



Figura 5. Organizimi i materialeve në sistemin fizik të arkivës së IKKL-së

Me pranimin e materialit, IKKL-ja vendos se në cilin fond të arkivës së tij duhet të vendoset ky material dhe gjithashtu cakton sinjaturën, kodin, që përfshin numrin dhe titullin e fondit apo koleksionit për ta identifikuar atë saktësisht në listat e përgjithshme të fondeve. Fondet pastaj ndahen në njësi organizative, të cilave gjithashtu u caktohet sinjatura, dhe ky kategorizim e lehtëson gjetjen e materialit që kërkohet për hulumtim, nga palët e jashtme apo nga vetë zyrtarët e IKKL-së.

Kategorizimi i lëndëve do bëhet sipas llojit dhe përmbajtjes së fondeve, por njëra prej kategorizimeve më të rëndësishme, e cila do të ndiqet për fondet dhe koleksionet në të cilat është e aplikueshme, është kategorizimi i lëndëve në njësi organizative sipas llojeve të krimeve dhe dëmeve të shkaktuara gjatë luftës. Sa i përket kategorizimit të krimeve, IKKL-ja klasifikon dhe kategorizon krimet e kryera gjatë luftës për qëllime të hulumtimit dhe dokumentimit (figura 6).



Figura 6. Klasifikimi i krimeve të luftës për qëllime të dokumentimit dhe hulumtimit

Ky proces mundëson një vlerësim të saktë të natyrës së këtyre krimeve dhe ndihmon në përcaktimin e përgjegjësiave për to. Kategoritë përfshijnë:



- **Krime me pasoja të rënda për njerëzit:** aktet që dëmtojnë drejtpërdrejt individët, si krimet kundër njeriut, duke përfshirë vrasjen, zhdukjen, skllavërinë, deportimin, torturën dhe përdhunimin dhe dhunën seksuale (në këtë kategori, përdhunimi dhe dhuna seksuale konsiderohen si një armë lufte ose një politikë sistematike që kontribuon në qëllime më të gjera si pastrimi etnik ose gjenocidi). Këto krime shkaktojnë vuajtje të rënda njerëzore, shkelje të të drejtave të njeriut dhe dëme sistematike për popullatën civile;
- **Krime me pasoja fizike dhe psikologjike/emocionale:** këto përfshijnë dëmtime fizike, plagë dhe dëmtime të tjera trupore, së bashku me trauma psikologjike, siç është çrregullimi post-traumatik i stresit (PTSD), depresioni dhe probleme të tjera të shëndetit mendor që lindin nga përvojat e luftës. Përdhunimi dhe dhuna seksuale, gjithashtu përfshihen këtu dhe i referohen efekteve të tyre të menjëhershme dhe afatgjata tek viktimat individuale, si dëmtime fizike, probleme shëndetësore kronike, çrregullime psikologjike dhe stigmë shoqërore;
- **Krime me pasoja ekonomike dhe materiale:** shkatërrimi ose dëmtimi i pronës, humbja e mjeteve të jetesës, zhvendosja e detyruar dhe pasoja të tjera ekonomike që minojnë mirëqenien dhe mbijetesën e popullatave të prekura;
- **Krime me pasoja mjedisore:** dëmtimi i ekosistemeve, ndotja mjedisore dhe shterimi i burimeve natyrore të shkaktuara nga lufta, duke ndikuar në balancën ekologjike të menjëhershme dhe afatgjatë;
- **Krime me pasoja kulturore dhe trashëgimore:** këto krime rezultojnë në shkatërrimin, dëmtimin ose vjedhjen e objekteve, monumenteve dhe vendeve me rëndësi kulturore, duke përbërë akte të kulturocidit. Pasojat përfshijnë erozionin e identitetit kulturor, humbjen e trashëgimisë dhe ndërprerjen e vazhdimësisë historike dhe fetare;
- **Krime të tjera me pasoja të gjëra sociale dhe individuale:** shkelje që nuk i përkasin drejtpërdrejt kategorive të mësipërme, por që ende përbëjnë shkelje të rënda sipas normave ndërkombëtare, siç është trafikimi i qenieve njerëzore dhe akte të tjera të dhunshme që ndikojnë rëndë tek individët dhe komunitetet.

Për sa i përket kategorisë së dëmeve, IKKL-ja klasifikon dhe kategorizon dëmet e shkaktuara gjatë luftës për qëllime dokumentimi dhe hulumtimi (figura 7).



Figura 7. Kategorizimi i dëmeve për qëllime të dokumentimit dhe hulumtimit

- **Dëme materiale:** dëme direkte që mund të matën lehtësisht (p.sh., shkatërrimi i shtëpive, dëmtimi i automjeteve, dëmtohen bagëtitë, dëmtimi i mjeteve bujqësore, vjedhja e sendeve me vlerë si ornamente, etj.) - në përmblendhje, dëme që mund të përkthehen në humbje ekonomike;



- **Dëme të integritetit funksional (emocionale dhe psikologjike):** dëme indirekte që nuk matën lehtësisht, por kanë pasoja afatgjata. Për këtë, matja e perceptimeve të individëve mbi dëmin është më e lehtë.

Përveç këtij kategorizimi, dëmet gjithashtu shqyrtohen në lidhje me palën e prekur. IKKL-ja do të vlerësojë dëmet në bazë të kategorive të mëposhtme:

- individëve;
- ambientit shoqëror;
- ambientit fizik;
- entiteteve private (përfshirë bizneset, organizatat jo qeveritare dhe instituteve tjera private).

IKKL-ja do të aplikojë kuadrin e matjes së dëmeve që është zhvilluar nga Profesorët Victoria Greenfield dhe Letizia Paoli, dhe që është testuar për matjen e dëmeve në procese të ndryshme në vende të ndryshme evropiane. Duke marrë parasysh se një kuadër matjeje dëmsh duhet të përshtatet me mjedisin në të cilin aplikohet dhe kontekstin e periudhës kur ka ndodhur konflikti, IKKL-ja do të zbatojë vetëm një pjesë të kuadrit të zhvilluar nga profesorët Greenfield dhe Paoli,—duke mos u fokusuar në aspektet që lidhen me dëmet në reputacion dhe privatësi.

Procesi i kategorizimit kryhet duke përdorur sisteme të kodifikimit manuale dhe digjitale. Për kategorizimin manual, përdoren metoda të tilla si shënime me ngjitëse, markera me ngjyra ose tabela për të shënuar dhe kategorizuar informacionin në dokumente fizike. Dokumentet vendosen në kuti të ndara, dhe etiketimi dhe indeksi janë pjesë përbërëse të procesit të sistematizimit dhe arkivimit.

Rishikimi dhe rregullimi i kategorive është thelbësor për të siguruar që sistemi i kodifikimit të mbetet i përshtatshëm me objektivat e arkivimit. Kodet duhet të rishikohen periodikisht për të siguruar që ato ende përputhen me qëllimet e arkivimit dhe për të identifikuar çdo kod që mund të jetë i paqartë ose i tepërt.

Listat e brendshme krijohen për të mbajtur një inventar të detajuar të të gjitha materialeve të mbledhura dhe të përpunuara. Këto lista sigurojnë që çdo dokument dhe copë dëshmi të regjistrohet dhe kategorizohet saktësisht, duke lehtësuar qasjen më të thjeshtë në të dhëna gjatë hulumtimeve dhe analizave të mëvonshme.

2.3.2 Përshkrimi

Një hap thelbësor në krijimin dhe mbajtjen e një arkivi me cilësi të lartë dhe të lehtë për t'u qasur është përshkrimi i materialeve arkivore. IKKL-ja do t'i referohet standardit ndërkombëtar ISAD(G) për këtë qëllim. Ky standard specifikon që përshkrimi duhet të fillojë nga më të përgjithshmet dhe të kalojë tek më të veçantat. Përkatesisht, për arkivin e IKKL-së, përshkrimi fillestar do të jetë i përgjithshëm, duke mbuluar fondet, dhe do të pasojë me përshkrime të koleksionit, njësisë organizative dhe artikujve të veçantë. Pas arkivimit, çdo artikull do të ketë një përshkrim të shkurtër në dosjen e tij, duke ofruar një përmbledhje të shkurtër të informacionit.

Përshkrimet në çdo nivel, nga fondet deri te artikulli më specifik, duhet të jenë të shkurtër dhe të përmbajnë një përmbledhje që përfshin të gjitha informacionet kyçe relevante. Kjo kërkon që arkivistët të jenë të informuar mirë për çdo artikull arkivor që përpunojnë.

Një procedurë tjetër e rëndësishme që arkivistët dhe ata që përpunojnë materialet duhet të ndjekin është rishikimi i vazhdueshëm i materialeve të përshkruara. Kjo përfshin ekzaminimin nëse përshkrimi mbetet i saktë dhe i plotë dhe përditësimin ose rishikimin e tij sipas nevojës. Nëse një rishikim

konsiderohet i nevojshëm, është thelbësore të ruhet përshkrimi i mëparshëm për të dokumentuar çdo ndryshim të bërë gjatë kohës.

2.3.3 Arkivimi fizik dhe arkivimi digjital

Pasi të përfundojnë proceset e përmendura më lart, materiali bëhet gati për t'u vendosur në depo arkivore të IKKL-së. Një zonë e caktuar dhe e shënuar në depo dhe në raftet e depozitës përdoret për të ruajtur materialin në një mënyrë që siguron qasje të lehtë sipas nevojës. Kushtet e depozitës arkivore ku do të ruhet materiali i arkivuar duhet të përputhen me standardet ndërkombëtare për arkivimin, me ISO-15489 që është standardi më relevant. Ky standard specifikon kushtet dhe dispozitat për mirëmbajtjen e arkivave (shih kapitullin 3). Pasi të jetë arkivuar fizikisht, materiali i përpunuar dhe i organizuar kalon në procesin e digjitalizimit. Digjitalizimi përfshin konvertimin e materialeve fizike në formate digjitale dhe organizimin e tyre në një arkiv digjital të strukturuar dhe të menaxhueshëm (figura 8).




Figura 8. Procesi i digjitalizimit

Procesi i digjitalizimit duhet të ndiqet nga disa hapa kyç:

- **Pastrimi i të dhënave:** para se të futen në arkivin digjital, të dhënat e mbledhura duhet të kalojnë në një proces pastrimi. Kjo përfshin standardizimin e formateve të të dhënave dhe eliminimin e gabimeve, mospërputhjeve ose të dhënave të munguara;
- **Konvertimi dhe kodimi:** dokumentet dhe materialet fizike që arkivohen konvertohen në formate digjitale të përshtatshme për ruajtje afatgjatë. Ky proces mund të përfshijë skanimin e dokumenteve, fotografive, ose materialeve të tjera dhe ruajtjen e tyre në formate si PDF, TIFF, JPEG, DOCX ose MP4;
- **Kontrolli i cilësisë:** çdo material digjital i krijuar i nënshtrohet një kontrolli të hollësishëm për të siguruar që të gjitha detajet janë të kapura me saktësi. Ky proces përfshin verifikimin e rezolucionit, qartësisë, dhe plotësisë së materialeve të skanuara ose regjistruara;
- **Krijimi i bazës së të dhënave:** çdo dokumenti dhe materiali digjital i bashkëngjiten të dhënat e detajuara, të cilat përfshijnë informacione rreth përmbajtjes, burimit, datës dhe kontekstit historik. Këto të dhëna janë të njëjtat me ato të cilat vendosen gjatë përpunimit dhe kategorizimit fizik;
- **Përdorimi i softuerëve të specializuar për arkivim:** pas digjitalizimit, materialet futen në një sistem të arkivimit digjital që lejon menaxhimin efikas të të dhënave. Ky sistem mundëson krijimin e kodeve dhe kategorive për materialet e ruajtura, duke përdorur softuerë të specializuar për



arkivimin e materialeve cilësore dhe sasiore. Procesi përfshin edhe kodimin e hapur, aksial dhe selektiv të materialeve, që ndihmon në organizimin dhe analizimin e tyre.

Materialet ruhen në një sistem me serverë të dedikuar që janë të mbrojtur nga dëmtimet fizike dhe teknike, të cilat fizikisht gjenden në hapësirat e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit. Krijohen kopje rezervë të të dhënave në disa lokacione për të garantuar sigurinë në rast të fatkeqësive ose incidenteve teknike. Ndonjëherë materialet digjitale janë të krijuara dhe qasja në to është e kufizuar dhe monitoruar rreptësisht. Kjo siguron që vetëm personeli i autorizuar të ketë qasje në të dhënat e ruajtura. Për më shumë informata rreth sistemit digjital të ruajtjes së të dhënave dhe arkivimit shih dokumentin e IKKL-së: *Ruajtja Digjitale Aktive dhe Arkivimi* (versioni 1.3).

2.3.4 Qasja në të dhëna

Qëllimi kryesor i mbledhjes, verifikimit, përpunimit dhe arkivimit të materialeve të lidhura me krimet e luftës të kryera gjatë luftës në Kosovë është të mundësojë qasjen për hulumtuesit e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe palët e tjera të interesuara. Arkiva fizike e IKKL-së është dizajnuar për ruajtjen afatgjatë të materialeve dhe për të siguruar qasje të lehtë për palët e interesuara. Qasja në materialet e arkivuara trajtohet me kujdes të veçantë, duke marrë parasysh ruajtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë në raste kur kjo konsiderohet e nevojshme dhe në raste specifike kur depozituesi vendos kushte. Ky proces është në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse, të cilat përcaktojnë kufizimet dhe kushtet për përdorimin e materialeve të ndjeshme. Sigurimi i qasjes në materialet arkivore të IKKL-së kërkon masa speciale, veçanërisht për materialet me një nivel të lartë ndjeshmërie që kërkojnë mbrojtje të rreptë të konfidencialitetit. Prandaj, është thelbësore të definohen qartë nivelet e klasifikimit të të dhënave në bazë të ndjeshmërisë dhe rëndësisë së tyre. Niveli i klasifikimit dhe mbrojtja e tyre përcaktohen në përputhje me ligjet në fuqi: Ligji Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacioneve të Klasifikuara, Ligjin Nr. 08/L-111 për Arkivat, dhe Ligji Nr. 08/L-205 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Për më tepër, këto nivele klasifikimi duhet të specifikojnë kush ka të drejtë të ketë akses dhe nën cilat kushte, duke siguruar që vetëm individët e autorizuar mund të kenë qasje në këto të dhëna. Duhet pasur kujdes në kontrollimin e qasjes në materialet fizike, duke siguruar që të gjitha materialet e kërkuara nga palët të dokumentohen për hyrje/dalje nga arkiva, duke përfshirë regjistrimin e zyrtarit që miratoi hyrjen/daljen e materialit.

Megjithatë, për sigurinë maksimale të materialeve të arkivuara dhe duke marrë parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë e materialeve, është thelbësore që të gjitha materialet të digjitalizohen dhe të kenë qasje përmes kompjuterëve, si brenda ambienteve të IKKL-së, ashtu edhe përmes internetit, përmes faqes zyrtare të internetit dhe një platforme digjitale të dedikuar për depozitën e të dhënave dhe qasje të lehtë. Kjo platformë duhet të dizajnohet për të lehtësuar hulumtimin e dokumenteve të ruajtura nga përdorues të ndryshëm, si hulumtues, gazetarë dhe publiku i përgjithshëm. Krijimi i një arkive digjitale publike është thelbësor për ruajtjen dhe përhapjen e të dhënave historike, duke siguruar qasje të qëndrueshme dhe të sigurt për brezat e ardhshëm. Në të njëjtën kohë, platforma digjitale siguron që të gjitha informacionet e publikuara trajtohen me kujdes, duke respektuar privatësinë dhe konfidencialitetin kur është e nevojshme. Për të mbrojtur privatësinë e materialeve të ndjeshme dhe qëllimin e përdorimit të tyre, IKKL-ja krijon filtra përmes të cilëve palët e interesuara duhet të kalojnë.

Përmes programeve të tij, sistemi digjital duhet të ofrojë mundësi të shumta hulumtimi, duke lejuar marrjen e informacionit të detajuar nga e gjithë materialet e digjitalizuara. Ai duhet të mundësojë që materialet të transkriptohen në disa gjuhë, në mënyrë që fjalët kyçe të mund të përdoren për marrjen e informacionit në mënyrë të lehtë nga hulumtues të ndryshëm ndërkombëtarë. Për më shumë detaje, shihni seksionin 4.1 më poshtë.

3 SIGURIA E ARKIVIT

Infrastruktura fizike e ruajtjes së të dhënave duhet të përfshijë një sistem të sigurt të bazës së të dhënave që mund të ruajë të gjitha të materialet arkivore të mbledhura. Ruajtja dhe mbrojtja e dokumenteve duhet të behet në hapësira të sigurta duke marrë parasysh tre faktorë: fizikë, kimikë dhe biologjikë (figura 9).



Figura 9. Faktorët kryesorë në ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumenteve që përfshijnë ato fizikë, kimikë dhe biologjikë

3.1 Mbrojtja e depos së arkivit nga faktorët fizikë

Mbrojtja nga faktorët fizikë përfshin sigurimin e një ambienti të veçantë për materialin e arkivuar, në mënyrë që të shmanget çdo rrezik dëmtimi fizik. Kjo arrihet duke futur materialin në kuti dhe fashikuj të veçantë, dhe pastaj duke i vendosur ato në rafte metalike specifike për mbajtje të materialit arkivor sipas llojit të atij materiali. Dyshemeja e depos duhet të ketë kapacitet të mbajë 1200 kg/m² për rafte jo-kompakte dhe 1700 kg/m² për rafte kompakte. Gjatësia maksimale e rafteve nuk duhet të jetë më shumë se 10 m dhe raftet duhet të jenë të vendosura larg mureve në distancë 0.70 – 0.80 m. Hapësira mes rafteve për qarkullim duhet të jetë jo më pak se 1 m.

Ndriçimi duhet të bëhet kryesisht nga burime të brendshme, duke shmangur kontaktin direkt me rrezet e diellit përmes dritareve, të cilat duhet të jenë të vogla dhe të mos përbëjnë më shumë se 10% të sipërfaqes së fasadës.

Secili lloj i materialit kërkon kushte optimale për ruajtje fizike afatgjatë:

- Materialet arkivore të letrës kërkojnë lagështi të ajrit nga 55% deri në 65% dhe temperaturë mes 13 deri 18 °C;
- Materialet fotografike kërkojnë që lagështia e ajrit të jetë mes 30% dhe 40% dhe temperatura të jetë më e ulët se 18 °C;
- Materialet filmike në medie magnetike duhet ruajtur në një ambient me lagështi ajri 30% deri 40% si dhe temperaturë 12 deri 18 °C;
- Materialet e ruajtura në disqe optike kërkojnë ruajtje në ambient me lagështi të ajrit 40% dhe temperaturë që nuk kalon 20 °C.

Për çdo material tjetër duhet shqyrtuar rregullat dhe standardet ndërkombëtare të arkivistikës për t'u siguruar që kushtet për ruajtje optimale afatgjatë janë plotësuar.



Një tjetër aspekt i rëndësishëm fizik është parandalimi i qasjes së paautorizuar në arkivë që mund të shkaktoj dëmtim apo humbje të materialit arkivor. Duhet siguruar që hapësira e arkivës është nën mbikëqyrje 24 orë nga kamerat dhe duhet përcjellë protokolle të rrepta që regjistrojnë hyrjet dhe daljet e personave në arkivë, si dhe materialin që merret dhe kthehet. Duhet të caktohet një person si kujdestar i depos së arkivit dhe të jetë i vetmi që ka autorizim për të hyrë brenda ose për t'i shoqëruar personat e tjerë që marrin leje për të hyrë brenda në arkiv. Ky person gjithashtu koordinohet me pjesën tjetër të stafit të IKKL-së për të gjetur dhe sjellë në sallën e studimit/verifikimit dokumente të cilat hynë në këto procese.

Për të pasur siguri më të lartë dhe ruajtje të garantuar të materialit, duhet krijuar një protokoll për personat që marrin autorizim të hynë në arkivë dhe për materialet që nxirren prej saj. Gjithçka duhet të regjistrohet me saktësi për të siguruar gjurmueshmërinë e lëvizjes së dokumenteve dhe materialeve arkivore.

3.2 Mbrojtja e depos së arkivit nga faktorët kimikë

Faktorët kimikë përfshijnë rreziqet që kanosen nga proceset kimike që qojnë në dëmtim të materialit arkivor duke shkaktuar vyshkje të letrës, dëmtim të materialeve filmike nga zjarri apo uji, tharje të letrës si pasojë e ajrit të thatë brenda depos, dhe rasteve të ngjashme. Për të mbrojtur arkivin nga këto rreziqe, hapësira e arkivës të jetë mirë e ajrosur dhe e mbrojtur mirë me sisteme kundër zjarrit që nuk përdorin ujë, pasi po ashtu uji mund të dëmtojë materialin.

Për të shmangur dëmtime potenciale të materialit nga uji ose zjarri, duhet siguruar që depo e arkivit nuk gjendet afër gjeneratorëve, apo pajisjeve të tjera elektrike të ndërtesës që mund të shkaktojnë aksidente që çojnë në përhapjen e zjarrit në depo. Gjithashtu, duhet siguruar që nuk kalojnë gypa të ujit apo kanalizimit ndër dysheme të arkivës apo përgjatë mureve, për të evituar dëmet eventuale që një shpërthim i këtyre gypave do mund të shkaktonte.

3.3 Mbrojtja e depos së arkivit nga faktorët biologjikë

Faktor tjetër që mund të dëmtojë materialin është ai biologjik; duhet marrë masa preventive që hapësira e arkivit të jetë e mbrojtur nga insektet dhe brejtësit, në mënyrë që materiali arkivor të jetë i mbrojtur për një afat të gjatë. Duhet mbikëqyrur hapësira e depos vazhdimisht për t'u siguruar që nuk ka rreziqe nga brejtësit apo insektet, dhe nëse vërehet ndonjë infiltrim biologjik, atëherë menjëherë duhet marrë masa për de-ratizim apo de-zinsektim, në mënyrë që të mos lejohet dëmtimi i materialit.

3.4 Plani për sigurinë e materialit arkivor në depo në rast të fatkeqësive

Për të siguruar mbrojtjen afatgjatë të materialit edhe në raste të fatkeqësive natyrore apo aksidenteve të ndryshme, duhet krijuar një protokoll me hapat që duhet të ndërmerren nga personeli i autorizuar për të shpëtuar materialin. Hapat duhet të përfshijnë:

- a) Lajmërimin e autoriteteve të sigurisë dhe reagimit të shpejtë;
- b) Sigurimin fizik të depos së arkivit;
- c) Evakuimin e materialit arkivor për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm;
- d) Restaurimin e materialit në rast të dëmtimit të tij nga ndonjë aksident apo fatkeqësi natyrore.

Përveç këtyre hapave të përgjithshëm, në rast fatkeqësie apo aksidenti duhet të ketë parasysh kushtet dhe rrethanat në të cilat gjendet depoja, për të krijuar një protokoll për reagim që përshtatet.



4 DEPARTAMENTI I HULUMTIMIT

Departamenti i Hulumtimit ka për mision planifikimin dhe zhvillimin e hulumtimeve profesionale dhe akademike me qëllim të krijimit dhe publikimit të të dhënave shkencore rreth krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, nevojave të viktimave dhe dëmeve të shkaktuara nga krimet.

Kjo metodologji përshkruan kornizën e përgjithshme për hulumtimin dhe analizat që do të kryhen nga Departamenti i Hulumtimit (figura 10). Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se çdo projekt hulumtues i ndërmarrë nga IKKL-ja do të trajtohet në mënyrë individuale dhe do të zhvillohet një metodologji specifike për secilin. Ky qasje siguron që metodologjia e hulumtimit të adresojë në mënyrë të duhur natyrën unike të secilës studim dhe kontekstin përkatës. Kështu, metodologjia e përgjithshme e përshkruar këtu shërben si një udhëzues bazë, ndërsa detajet dhe proceset specifike do të zhvillohen për çdo projekt hulumtues individual.

Me qëllim të kryerjes së hulumtimeve shkencore dhe publikimit të rezultateve të hulumtimit, IKKL-ja do të bashkëpunoj edhe me institucionet shkencore dhe akademike në Kosovë dhe jashtë saj.



Figura 10. Hapat e përfshirë në procesin e punës së Departamentit të Hulumtimit

4.1 Menaxhimi dhe përdorimi i materialeve të arkivuara për hulumtim

Departamenti i Hulumtimit i IKKL-së ka për detyrë të zhvillojë procedura dhe standarde për ofrimin e qasjes dhe përdorimin e materialeve të IKKL-së për qëllime hulumtimi. Në këtë drejtim, do të krijohen protokolle standarde dhe specifike që do të përcaktojnë mënyrën se si materialet arkivore mund të përdoren nga studiuesit, duke u siguruar që qasja dhe përdorimi i tyre bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto procedura gjithashtu do të përfshijnë udhëzime të detajuara për sigurimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së materialeve gjatë përdorimit për qëllime hulumtimi, duke minimizuar rrezikun e humbjes ose dëmtimit të të dhënave.

Siguria dhe integriteti i të dhënave dhe materialeve të IKKLK-së janë thelbësore për çdo aktivitet hulumtues. Prandaj, një pjesë e rëndësishme e metodologjisë përfshin hartimin e procedurave të posaçme që të dhënat dhe materialet të ruhen nga çdo lloj dëmtimi gjatë përdorimit të tyre. Këto



procedura do të përfshijnë masa për të parandaluar keqpërdorimin, qasjen e paautorizuar dhe çdo formë tjetër të rrezikut që mund të dëmtojë integritetin e të dhënave.

Për të lehtësuar qasjen në informacion dhe për të mbështetur hulumtuesit në punën e tyre, Departamenti i Hulumtimit do të ofrojë shërbime informuese dhe udhëzuese përmes katalogjeve manualë dhe elektronikë. Këto shërbime do të përfshijnë katalogje të të dhënave, referenca dhe burime të tjera informacioni për t'u ofruar hulumtuesve qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në materialet e arkivuara. Përveç kësaj, do të ofrohet mbështetje për informacionin dhe teknologjinë e komunikimit, përfshirë trajnime dhe udhëzime për përdoruesit që kanë nevojë për asistencë me platformat digjitale.

Departamenti i Hulumtimit do të organizojë gjithashtu fushata vetëdijësuese dhe informuese për të promovuar njohjen dhe përdorimin e materialeve të IKKL-së për qëllime hulumtuese. Këto fushata do të përfshijnë bashkëpunime me medie, organizata dhe institucione të tjera, për të rritur ndërgjegjësimin publik, mbi mundësitë e hulumtimit dhe vlerën e ruajtjes dhe përdorimit të këtyre materialeve. Këto aktivitete, do të ndjekin gjithmonë legjisllacionin aktual dhe do të synojnë të mbështesin komunitetin hulumtues në përdorimin efektiv dhe të përgjegjshëm të të dhënave të Institutit.

4.2 Hulumtimet akademike

Procesi i hulumtimit fillon me identifikimin e rasteve të caktuara për hulumtim. Përzgjedhja e rasteve përfshin një analizë të kujdesshme të ndryshoreve (variabla) si vendndodhja dhe lloji i krimit. Ky proces siguron përfaqësim të përshtatshëm dhe të diversifikuar të rasteve për analizë dhe hulumtim. Një hap i rëndësishëm është identifikimi i vendndodhjeve ku janë kryer krimet, përfshirë analiza e rajoneve dhe përcaktimi i zonave ku do të fokusohet hulumtimi, qofshin ato urbane apo rurale.

Identifikimi i dëshmitarëve, të mbijetuarve dhe viktimave është thelbësor për mbledhjen e dëshmive të drejtpërdrejta ose informacioneve të vlefshme për krimet e kryera. Procesi përfshin krijimin e kontakteve me komunitetet lokale dhe individët e gatshëm për të ndarë përvojat e tyre. Përzgjedhja e rasteve bazohet në teknika të mostrave jo-rastësore dhe efektin e 'topëthit të borës' (snowball effect), që ndihmon në zgjerimin e bazës së të dhënave dhe përfshirjen e një game të gjerë perspektivash.

Hulumtuesit mbledhin dëshmi të shkruara, fotografi, audio dhe video, si dhe kryejnë intervista për verifikimin dhe analizimin e të dhënave. Ky proces siguron që të gjitha dëshmitë dhe materialet e tjera të mbledhura janë të sakta dhe të plota. Për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave, përdoren teknika të triangulimit dhe intervistimi i kombinuar me mbledhjen e materialeve shtesë si dokumentet, fotografitë, regjistrime audio-vizuale që ofrojnë prova të rëndësishme.

Fillimisht, plotësohet formulari i të dhënave demografike, për të vazhduar me intervistën që përmban pyetje biografike dhe pyetësorë gjysmë të strukturuar. Intervistat fillojnë me pyetje biografike për të krijuar kontekst dhe vazhdojnë me pyetjet e standardizuara për të siguruar mbledhjen e të dhënave të qëndrueshme dhe të krahasueshme. Procesi mbështetet nga një protokoll standard që garanton përputhjen me standardet etike, duke përfshirë *udhëzimet metodologjike* të cilat përpilohen sipas nevojave të hulumtimit.

4.3 Digjitalizimi i materialeve hulumtuese

Të dhënat e mbledhura analizohen përmes metodave sasiore dhe cilësore. Statistikat përshkruese dhe analizat sasiore ndihmojnë në përmbledhjen e tipareve kryesore të të dhënave, duke përfshirë analiza kohore dhe gjeohapësinore. Për të dhënat cilësore, përdoren teknika të analizës tematike për identifikimin e modeleve të përsëritura në hulumtim. Analizat gjeohapësinore përdorin teknologji GIS



për të krijuar harta që tregojnë shpërndarjen e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Këto analiza ndihmojnë në identifikimin e modeleve dhe lidhjeve midis vendndodhjeve të krimeve dhe faktorëve të tjerë gjeografikë dhe kohorë.

Për të përmirësuar kuptimin dhe prezantimin e rezultateve, përdoren teknika të vizualizimit të të dhënave përmes mjeteve grafike dhe kartografike. Këto përfshijnë krijimin e hartave të krimeve, rrjedhën e ngjarjeve dhe lidhjet ndërmjet personave dhe ngjarjeve të ndryshme. Vizualizimi i të dhënave lehtëson identifikimin e modeleve të fshehura dhe ndihmon në komunikimin e rezultateve të hulumtimit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për audiencën e gjerë. Gjithashtu, këto teknika shërbejnë si bazë për krijimin e materialeve për Muzeun Digjital, duke përfshirë ekspozita interaktive dhe materiale edukative që dokumentojnë dhe përjetësojnë ngjarjet dhe përvojat e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Këto materiale digjitale ndihmojnë në ruajtjen e kujtesës historike dhe mundësojnë qasje të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Rezultatet e hulumtimeve do të prezantohen në konferenca dhe do të publikohen në formate të ndryshme, si libra, broshura, artikuj shkencorë dhe botime të veçanta. Për të arritur një audiencë më të gjerë, materialet digjitale, përfshirë video dhe dokumentarë, do të publikohen në ueb dhe rrjetet sociale. Teknologjitë e reja, si inteligjenca artificiale, do të përdoren për të ndihmuar në përpilimin e narrativëve fillestare dhe në hulumtimin online të materialeve specifike brenda arkivës së IKKL-së. Kjo qasje e integruar ndihmon në dokumentimin e krimeve të luftës dhe në sigurimin e drejtësisë për viktimat e tyre.

4.4 Analizat e specializuara

IKKL planifikon, organizon dhe kryen analiza të thelluara që përputhen me kërkesat specifike të institucioneve si Zyra e Kryeministrit, Qeveria, Kuvendi, dhe Presidenca. Procesi fillon me planifikimin e analizave të specializuara, ku bëhet identifikimi i nevojave të institucioneve publike dhe përcaktohet korniza metodologjike për secilën analizë të kërkuar. Këto analiza përfshijnë vlerësimin e dëmeve psiko-sociale, emocionale dhe institucionale të viktimave të krimeve të kryera gjatë luftës, si dhe matjen e dëmeve ekonomike dhe shoqërore. Çdo analizë kryhet me kujdesin më të madh për të siguruar që rezultatet të jenë të sakta, të besueshme dhe të vlefshme për formulimin e politikave dhe vendimeve strategjike të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera janë thelbësore për këtë proces. Aktivitetet duhet të jenë të sinkronizuara me përpjekjet e tjera institucionale, duke krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi që ndihmon në shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës.

Analizat e specializuara mbështeten në përdorimin e të dhënave dhe dokumenteve që disponon IKKL-ja. Në këtë kontekst, ekspertiza profesionale e stafit është thelbësore për të kryer një vlerësim të thelluar dhe për të ofruar mbështetje të kualifikuar për institucionet e drejtësisë dhe të tjera që trajtojnë çështje të lidhura me krimet e luftës dhe pasojat e tyre.

5 KONKLUZION

Në përfundim, metodologjia e shtjelluar në këtë dokument përfaqëson një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për mbledhjen, verifikimin, përpunimin, arkivimin, hulumtimin dhe publikimin e të dhënave, duke siguruar që çdo hap përgjatë procesit përmbushë standardet më të larta profesionale dhe etike. E tërë metodologjia është ndërtuar mbi një bazë solide të literaturës shkencore, përvojave të mëparshme dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, duke marrë parasysh kontekstin specifik të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.



Metodologjia është dizajnuar për të ofruar një udhëzues të qartë dhe të strukturuar, duke harmonizuar proceset dhe duke minimizuar kompleksitetin në zbatimin e saj. Në këtë mënyrë, metodologjia jo vetëm që përmbush nevojat aktuale të IKKL-së, por gjithashtu është e ndërtuar për t'u përshtatur dhe zhvilluar më tej në përputhje me sfidat dhe kërkesat e ardhshme, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Metodologjia e punës në IKKL krijon një kornizë të qëndrueshme dhe afatgjatë për dokumentimin dhe hulumtimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, duke siguruar që ato të mos harrohen dhe të dokumentohet e vërteta historike bazuar në përvojat më të mira dhe në metoda shkencore.